



CB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCES BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 3436 prot.Vlorë, më 19.02 2026PROJEKTVENDIM
Nr. _____, datë _____, 2026

“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR TË ARDHURAT 2027-2029”

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 2, nenin 9, pika 1.1/b të Kreut III, nenin 34, pika 6, nenin 41, pika 1, si dhe nenin 64, pika c të Kreut X, i ndryshuar;
Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37;
Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse; Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2025, të Ministria e Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028”; Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore;

1. Të miratojë tavanet përgatitore për të ardhurat 2027-2029:

	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Plani i transfertës së pakushtëzuar	798,527	904,875	970,640	1,016,956	1,067,734	1,067,734
Plani i transfertës specifike	485,785	592,561	651,079	651,079	651,079	651,079
Plani i të ardhurave të Bashkisë Vlorë	1,411,302	2,308,523	2,914,721	3,060,458	3,213,480	3,410,772
Totali i të ardhurave	2,695,614	3,805,959	4,536,440	4,728,493	4,932,293	5,129,585

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETAR
Brunilda Mersini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCË BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 3436 prot.

Vlorë, më 19.02 2026

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029**

Të nderuar Këshilltar,

Ky projektvendim paraqitet për miratim bazuar në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 2, nenin 9, pika 1.1/b, nenin 34, pika 6, nenin 40, nenin 41, pika 1, si dhe nenin 64, pika c, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenet 4, 33, 34, 35, 36 dhe 37;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse;
- Ligjin vjetor “Për Buxhetin e Shtetit” për vitin përkatës;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.7 datë 28.02.2025 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028;
- Procedurat Standarde për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Projektvendimi që ju paraqitet për miratim është një ndër aktet përgatitore në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Vlorë.

Qëllimi i tij është miratimi i treguesve paraprakë të të ardhurave, të cilët shërbejnë si bazë për vijimin e fazave të mëtejshme të përgatitjes së dokumentit përfundimtar të PBA-së.

Analiza dhe parashikimi i të ardhurave për periudhën 2027–2029 janë ndërtuar mbi:

- analizën e realizimit faktik të të ardhurave në vitet 2024–2025;
- trendin e rritjes së të ardhurave të veta;
- politikat fiskale vendore në fuqi;
- transfertat e parashikuara nga buxheti i shtetit.

Të ardhurat e veta të Bashkisë Vlorë

Parashikohen në:

- 3,060,458 mijë lekë për vitin 2027
- 3,213,480 mijë lekë për vitin 2028
- 3,410,772 mijë lekë për vitin 2029

Rritja progresive e të ardhurave të veta mbështetet në përmirësimin e administrimit fiskal, forcimin e mbledhjes së detyrimeve, zgjerimin e bazës së taksapaguesve dhe rritjen e eficiencës së strukturave përkatëse.

Treguesit e paraqitur janë tregues fillestarë përgatitorë dhe mund të pësojnë rishikim në vijim të procesit të plotë të hartimit të PBA-së 2027–2029, në varësi të ecurisë së realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2026, përcaktimeve përfundimtare nga organet qendrore, prioriteteve strategjike të zhvillimit vendor.

Hartimi i këtij dokumenti synon garantimin e një planifikimi realist dhe të qëndrueshëm financiar, ruajtjen e ekuilibrit buxhetor dhe respektimin e disiplinës fiskale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këto kushte, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e këtij projektvendimi, me qëllim vijimin e procedurave për përgatitjen dhe miratimin përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 të Bashkisë Vlorë.

KRYETAR
Brunilda Mersini

